



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV**

Nr. 1424/3 prot.

Tiranë më 17.10.2018

**VENDIM**

Nr. 58, datë 17.10.2018

**MBI**

**ZBATIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", neneve 77-112 të Ligjit Nr.44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit Fondacioni Shqiptaro Amerikan "*Harry Fultz*",

**KONSTATOVA SE:**

Në zbatim të Urdhrit Nr.230, datë 20.09.2018 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për kryerjen e hetimit administrativ, më datë 02.10.2018 grupi i inspektimit të Drejtorisë së Hetimit Administrativ filloi procesin e hetimit administrativ pranë kontrolluesit me objekt:

- Zbatimi i Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit, Fondacioni Shqiptaro Amerikan "*Harry Fultz*".

Në funksion të Ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar, Fondacioni Shqiptaro Amerikan "*Harry Fultz*", është kontrollues i cili mbledh dhe përpunon të dhëna personale të kategorive "*punonjës*", "*nxënës*" dhe "*prindër*".

Kontrolluesi Fondacioni Shqiptaro Amerikan "*Harry Fultz*", është subjekt juridik, me NIPT: J61828093P.

Në datë 04.10.2018, grupi i kontrollit përfundoi hetimin administrativ duke e finalizuar me procesverbalin e mbajtur për këtë qëllim, prej nga u konstatua si më poshtë vijon:

1. Kontrolluesi Fondacioni Shqiptaro Amerikan "Harry Fultz", ka kryer detyrimin për "Njoftim" pranë Zyrës së Komisionerit mbi përpunimin e të dhënave personale në zbatim të nenit 21 të ligjit por në zbatim të nenit 22 të tij, nuk ka kryer përditësimin në vite të këtij njoftimi: *rubrika 3.1* (nxënës, nëpunës; duhet njoftuar që grumbullohen dhe të dhënat për kategoritë, mësues dhe prindër). Kontrolluesi duhej të njoftonte Zyrën e Komisionerit për pajisjen e institucionit me sistemin e kamerave CCTV.
2. Kontrolluesi Fondacioni Shqiptaro Amerikan "Harry Fultz", nuk ka hartuar rregulloren specifike për mbrojtjen e të dhënave personale, ashtu si rezulton dhe në formularin e njoftimit të deklaruar nga vetë kontrolluesi, e konkretisht rubrika 10.1 e formularit.
3. Në dosjet e personelit gjenden të nënshkruara "*Deklaratat e Konfidencialitetit*", me punëmarrësit të cilët kanë akses në përpunimin e të dhënave personale.
4. Ambientet e brendshme ku kontrolluesi ushtron aktivitetet janë të mbikëqyrura nëpërmjet sistemit të video-vëzhgimit CCTV. Konstatohet që ka tabela informuese mbi prezencën e sistemit të Video - Vëzhgimit CCTV, sipas modelit standard të kërkuar nga Komisioneri. Kjo tabelë duhet të korrigjohet për sa i përket adresës së kontrolluesit dhe personit të kontaktit. Koha e ruajtjes së të dhënave në sistem konstatohet të jetë 30 ditë, por nuk ka një rregullore për mbarëvajtjen e këtij sistemi.
5. Kontrolluesi Fondacioni Shqiptaro Amerikan "Harry Fultz", ka marrëveshje dypalëshe me ofruesin e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, shoqërinë "Erald" sh.p.k., por nuk ka marrëveshje konfidencialiteti me këtë shoqëri.
6. Kontrolluesi Fondacioni Shqiptaro Amerikan "Harry Fultz", në faqen e tij zyrtare, nuk ka të publikuar "*Politikat e Privatësisë*".

#### **Disa nga aktet e mësipërme përbëjnë shkelje administrative:**

- Konstatimi i pikës së parë përbën shkelje administrative të nenit 21 dhe 22 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" cili shprehet: "Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë...". Përditësimi i njoftimit është një nga detyrimet më të rëndësishme ligjore i cili në vështrim të nenit 21 të ligjit, duhet të kryhet kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji. Mos kryerja në kohë e këtij detyrimi, ngarkon kontrolluesin me përgjegjësi administrative të sanksionueshme sipas nenit 39, pika 1, germa "d" të Ligjit nr. 9887/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", me gjobë nga 10 000 deri në 500.000 lekë.
- Konstatimi i pikës së dytë përbën shkelje administrative të nenit 27 të Ligjit, Vendimit nr. 6/2013 "*Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale*" dhe Udhëzimit Nr.21/2012 të Komisionerit "*Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha*".

Neni 27 i ligjit shprehet:

“1. Kontrolluesi ose përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi..etj”.

Duhet kuptuar drejt nga kontrolluesi rëndësia që ka hartimi një rregulloreje të mirëfilltë për mbrojtjen e të dhënave personale, dhe përdorimi i saj nga nëpunësit e tij, si një akt bazë i cili ndërgjegjëson dhe detyron punonjësit për ruajtjen e konfidencialitetit, ruajtjen nga keqpërdorimi dhe mënyrën e administrimit të të dhënave personale.

Mos kryerja në kohë e këtij detyrimi, ngarkon kontrolluesin me përgjegjësi administrative të sanksionueshme sipas nenit 39, pika 1, germa “dh” të Ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, me gjobë nga 10 000 deri në 150.000 lekë.

- Konstatimi i pikës së katërt, (mungesa e rregullores për sistemin vëzhgues të kamerave) përbën shkelje administrative të nenit 27 të Ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar dhe Udhëzimit Nr.3 datë 05.03.2010 të Komisionerit “Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”.
- Konstatimi i pikës së pestë, përbën shkelje administrative të nenit 20 të Ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar dhe Udhëzimit nr.19/2012 të Komisionerit “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”. Neni 20 i Ligjit shprehet:  
“1. Kontrolluesit, për përpunimin e të dhënave personale, mund të punësojnë përpunues, të cilët garantojnë përdorimin e ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave. Çdo përpunues i të dhënave personale ka këto detyrime:  
a) të përpunojë të dhënat vetëm në përputhje me udhëzimet e kontrolluesit; të mos i transmetojë ato, përveç kur ka marrë udhëzim nga kontrolluesi;  
b) të marrë të gjitha masat e sigurisë, sipas këtij ligji dhe të punësojë operatorë, të cilët kanë detyrimin për ruajtjen e fshehtësisë;  
c) të krijojë, në marrëveshje me kontrolluesin, kushtet e nevojshme teknike dhe organizative për përmbushjen e detyrimeve të kontrolluesit, për të siguruar të drejtat e subjekteve të të dhënave personale;  
ç) t’i dorëzojë kontrolluesit, pas përfundimit të shërbimit të përpunimit, të gjitha rezultatet e përpunimit dhe dokumentacionit, që përmban të dhëna ose t’i mbajë apo t’i shkatërrojë ato me kërkesë të kontrolluesit;  
d) të vërë në dispozicion të kontrolluesit të gjithë informacionin e nevojshëm, për të kontrolluar përputhshmërinë me detyrimet, që rrjedhin sipas shkronjave të mësipërme.  
2. Detyrimet e pikës 1 përcaktohen në kontratën e shkruar e kontrolluesit me përpunuesin”.

Mos kryerja në kohë e këtij detyrimi, ngarkon kontrolluesin me përgjegjësi administrative të sanksionueshme sipas nenit 39, pika 1, germa "ç" të Ligjit nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", me gjobë nga 10 000 deri në 300.000 lekë.

- Konstatimi i pikës së gjashtë, përbën shkelje administrative të nenit 18 të Ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar. Informacioni i publikuar në "Politikat e Privatësisë", duhet të ketë për qëllim informimin e subjekteve të të dhënave që vizitojnë këtë portal, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave, masat e sigurisë, ruajtjen e konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.

Neni 18 i ligjit, shprehet:

"1. Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t'i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit, përveç rastit kur subjekti i të dhënave është në dijeni të këtij informacioni. Kontrolluesi duhet të informojë subjektin e të dhënave për të drejtën për akses, si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tij...etj".

Mos kryerja në kohë e këtij detyrimi, ngarkon kontrolluesin me përgjegjësi administrative të sanksionueshme sipas nenit 39, pika 1, germa "b" të Ligjit nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", me gjobë nga 10 000 deri në 300.000 lekë.

Në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", kontrolluesi Fondacioni Shqiptaro Amerikan "Harry Fultz", është njoftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, e cila u zhvillua në datën 16.10.2018, pranë ambienteve të Zyrës së Komisionerit. Kontrolluesi është paraqitur në seancë dëgjimore për të parashtruar pretendimet në lidhje me shkeljet administrative të konstatuara në kontrollin e ushtruar pranë tij, pretendime të cilat i ka nisur me shkrim në datë 05.10.2018, depozituar me nr.1485 prot., në protokollin e KDIMDP-së. Në këtë shkresë, kontrolluesi shprehet se ka plotësuar:

1. Formularin e Njoftimit i përditësuar, i dokumentuar.
2. Janë vendosur tabelat informuese e dokumentuar.
3. Është hartuar rregullorja "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", e dokumentuar.
4. Është hartuar dhe formalizuar marrëveshja e konfidencialitetit me përpunuesin, shoqërinë "Erald" sh.p.k., e dokumentuar.
5. Në faqen zyrtare të Fondacionit Shqiptaro Amerikan "Harry Fultz", u verifikua publikimi i rubrikës "Politikat e Privatësisë".

Kontrolluesi Fondacioni Shqiptaro Amerikan "Harry Fultz", në formën ligjore të aktivitetit të tij tregtar, është person juridik dhe sipas nenit 39/2 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, për kundërvajtjet e

mësipërme administrative, dënohet me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktet se, kontrolluesi ka dijeni për ligjin, dhe kontrolluesi është në kushtet e nenit 30 të ligjit pika 2 (rastet e shkeljeve të përsëritura), pasi Komisioneri ka dalë me aktin Nr.27, datë 13.10.2011 për dënimin administrativ me gjobë, në masën e 30.000 (tridhjetëmijë) lekëve, për mos përmbushje të detyrimit të njoftimit.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit gjithashtu, ka parasysh faktin se, kontrolluesi ka reaguar në mënyrë të menjëhershme, në rikuperimin e gjetjeve të grupit të kontrollit.

Shkeljet e konstatuara janë serioze, pasi ato lidhen ngushtë me garantimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave personale, saktësinë që të dhënat duhet të kenë dhe kur është e nevojshme, ato duhet të përditësohen duke ndërmarrë çdo hap të arsyeshëm për të fshirë apo korrigjuar të dhënat e pasakta apo të paplota në lidhje me qëllimin për të cilin ato janë mbledhur apo përpunohen më tej.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Në zbatim të neneve 27, 29, 30, 39 pika 1, germa "dh", si dhe nenet 40 dhe 41 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale",

### **V E N D O S A:**

1. Dënimin e kontrolluesit Fondacioni Shqiptaro Amerikan "Harry Fultz", me gjobë në vlerën 50.000 (pesëdhjetëmijë) lekë për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".
2. Gjoba arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky vendim u shpall sot më 17.10.2018.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

